



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1653/1 Prot.

Roskovec, më 26.02.2026

Procesverbal Nr.2

-I mbajtur sot, datë 26.02.2026, ora 13⁰⁰, në mbledhjen e Këshillit të Bashkisë, mbledhje e radhës, me rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.
2. Informacion mbi Vendimet e Këshillit të mbledhjes së muajit Janar 2026.
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak.
4. Për dhënien e Ndihmës Ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për periudhën 1-31 Janar 2026.
5. Për një sistemim të pikës III në vendimin Nr.05 datë 29.01.2026.
6. Për miratimin e vlerës maksimale të subvencionimit të qirasë dhe nivelit të qirasë mesatare në tregun e lirë për vitin 2026.
7. Për miratimin e listës së familjeve dhe individëve, që përfitojnë subvencionin e qirasë.
8. Për miratimin e listës së përfituesve nga programi “Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara”.
9. Për miratimin e bashkëfinancimit për programet e strehimit social, fond i miratuar me VKB Nr.71 datë 24.12.2025 “Për miratimin e dokumentit përfundimtar të PBA 2026-2028 dhe buxhetit të vitit 2026”.
10. Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Bashkisë Roskovec dhe Ndërmarrjes vartëse.
11. Për shtesë fondesh nga të ardhurat e trashëguara në buxhetin e vitit 2026.
12. Për miratimin e raportit për vlerësimin dhe parashikimin afatmesëm të të ardhurave 2027-2029.
13. Diskutime dhe komente të qytetarëve.

Ora e hapjes së mbledhjes: 13¹²

Këshilltarët prezent: A.Plaka, A.Lamaj, Rr.Hazizi, L.Goga, E.Buzi, Zh.Metushi, E.Kaçeli, N.Zeka, H.Hajdini, J.Begaj, S.Bibo Qamili, Dh.Malka.

Këshilltarët që mungojnë: E.Çepele, F.Hoxha, E.Toska, E.Xhaxhaj, P.Toro, A.Hoxha, V.Çepele, A.Pelo, F.Feleqi.

Prezent nga bashkia: Nënkryetari M.Goga, Dr.Financës O.Goga, Dr.Ardhurave Vendore S.Çepele, Dr.Urbanistikës E.Hoxha, Sp/Strehimit Social Xh.Duka, P/Shërbimit Social E.Kola.

Me plotësimin e kuorumit, Kryetari hap mbledhjen. Prezent në fillimin e mbledhjes janë 11 këshilltarë. Kryetari – përshëndetje të gjithëve të nderuar këshilltar, faleminderit që jeni bërë pjesë e kësaj mbledhje të Këshillit të Bashkisë Roskovec. Në radhë të parë duke qënë se jemi në një muaj të veçantë, më lejoni që edhe në emrin tuaj tju uroj gjithë besimtarëve musliman për një agjërim të lehtë dhe të pranuar, meqënëse ky është një muaj i veçantë siç thashë. Duke vënë re se në këtë sallë sot janë të pranishëm 11 këshilltar, do të thotë se kuorumi i nevojshëm për zhvillimin e kësaj mbledhje është i pranishëm. Do doja që përpara se të miratojmë rendin e ditës tju bëj me dije se nga ana e administratës ju është shpërndarë dhe në vendet tuaja..Në këtë moment vjen këshilltarja Dh.Malka, prezent tani në sallë janë 12 këshilltar. Kryetari- tashmë jemi bërë 12 këshilltar. Ju keni në vendet tuaja keni të shpërndarë një projekt-vendim i cili ka të bëjë me një saktësim në lidhje me një vendim të mbledhjes së kaluar, nuk ndryshon thelbi i vendimit, vetëm është një saktësim i origjinës së fondeve që trupëzohen në buxhetin e Bashkisë Roskovec. Gjithashtu na është kërkuar që në rendin e ditës të shtojmë dhe një informacion, pra rendi i ditës që ju është shpërndarë juve në datë 20.02.2026, ju lutem pak vëmendje, na është kërkuar nga ana e administratës që të shtojmë dhe një relacion, është informacion në fakt, relativ, nuk ka nevojë për votim, thjesht do të raportohet këtu informacion për projektin “Qeverisja e mirë përmesë pjesëmarrjes aktive në bashkëfinancimin e projekteve”. Leksi- informacionin e ke aty? Kryetari- po. Leksi-se nuk e kemi këtë. Kryetari- është informacion. Sekretare e Këshillit- është informacion nuk është për votim. Kryetari- është një çështje e cila nuk do të ketë nevojë për votim..Leksi- jo dakort, unë thashë kemi projekt-vendimin për saktësimin e asaj..Kryetari- projekt-vendimi që ju keni ka të bëjë thashë me saktësimin në vendimin e mbledhjes së muajit të kaluar..Leksi- tek pika 5 është ky projekt-vendimi që kemi këtu..Sekretarja- atë e keni ju, thjesht është bërë një saktësim. Kryetari- e relatuar dhe e saktësuar ju ka ardhur projekt-vendimi për saktësimin. Gjithashtu po ju thoja që në fund të rendit ose në këtë rend dite do të shtojmë dhe një informacion, i cili nuk ka nevojë për votim.

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.

Kryetari – kush është dakort të miratojmë rendin e ditës së kësaj mbledhje, me shtesën që sapo ju përmenda? Kryetari hedh në votim rendin e ditës me ndryshimin dhe shtesën e bërë si më sipër dhe miratohet unanimitet me 12 vota pro. Kryetari- me votat e të gjithë këshilltarëve të pranishëm miratohet rendi i ditës, faleminderit për votimin. Dhurata- Kryetar më fal një moment të lutem..Kryetari- po, fjala është për znj.Dhurata. Dhurata- meqënëse neve sa herë ju keni kërkuar, ne të grupit tjetër ne gjithmonë i kemi plotësuar ato kërkesat tuaja, kisha dhe unë një kërkesë. Në fakt unë doja që të ishte prezent Kryetarja e Bashkisë, është e mundur? Se dhe nëse ajo nuk është e mundur, pastaj kemi dhe Nënkryetarin këtu Zëvendëskryetarin, po është e mundur që të jetë Kryetarja sot se kishim për ti bërë një pyetje, flas në emër të qytetarëve të Sukut..Kryetari- atëherë do doja tju pyes juve, do donit që të ishte gjatë gjithë zhvillimit të mbledhjes apo në një pikë që ne..Dhurata- po thjesht të na kishte dhënë një përgjigje në lidhje me pyetjet që kanë bërë qytetarët..Kryetari -apo në një pikë që ne kemi parashikuar? Dhurata- jo ska lidhje me pikat..Kryetari- kemi parashikuar këtu nga mbledhja e kaluar, kemi parashikuar që të vij një specialist i Drejtorisë së Investimeve, doni ta lëmë që të jetë në atë moment? Dhurata- jo ska lidhje me atë..Kryetari- apo do donit që të ishte..Dhurata- jo do doja për momentin thjesht doja një përgjigje në lidhje me atë projektin që po zhvillohet në Suk..Kryetari- po pra po, do duhet ta

njoftojmë që të vij që në fillim të mbledhjes apo të vazhdojmë ne me procedurën dhe ta thërrasim? Jorgo- po të vij tani..Dhurata- po të vij 2 minuta nëse mundet, thjesht të marrim informacion meqënëse pastaj..Kryetari- po sepse ne duhet të zhvillojmë rendin, ka të bëj kjo pyetje me ndonjë pikë? Dhurata- a është e mundur Kryetar, se në të kundërt është dhe Nënkryetari këtu i cili ka qënë prezent..Kryetari- po patjetër që ne do ti bëjmë kërkesën..Dhurata- them edhe ky se ky ka qënë prezent në dëgjesën publike dhe Maksi..Kryetari- patjetër që do të bëjmë kërkesën por ama ne do të ndjekim dhe rendin tonë, po në rregull..Dhurata-ok, nëse është dakort dhe Maksi mund të na japi një përgjigje, se qytetarët e duan një përgjigje, se ka qënë dhe ky prezent atje..Kryetari- Maksit, është e mundur? Maksi- ne ishim në takim me Kryetaren dhe Kryetarja tha unë do largohenm për në Tiranë. Unë mund ti bëj kërkesë përsëri tani, po në qoftë se do të marr menjëherë përgjigje që tua jap në një moment, sa ti shkruaj, jam dakort. Kryetari- mirë faleminderit, po presim përgjigje, në mungesë do ta marrim nga..Dhurata- sa të mbarojë mbledhja, sa të shkëputet Kryetarja..Maksi- spo them sa të mbarojë mbledhja, ju vazhdoni mbledhjen me ndihmat, sa të marrim një përgjigje..Dhurata- se një pyetje mund ta japësh edhe ti se ke informacion. Kryetari- po patjetër. Maksi- përgjigje se pyetjen do ta bësh ti. Dhurata- unë përgjigje po them, mund të na e japësh edhe ti. Tani Kryetarja mundet apo smundet? Kryetari- atëherë ndërkohë që presim përgjigje, a mund të vazhdojmë me procedurat se duke parë që kemi disa pika në rendin e ditës për ti shqyrtuar sot.

2. Informacion mbi Vendimet e Këshillit të mbledhjes së muajit Janar 2026.

Kryetari- atëherë të nderuar këshilltar pasi kemi miratuar rendin e ditës, ju ftoj që të dëgjojmë një informacion të shkurtër mbi vendimet e Këshillit të mbledhjes së muajit Janar 2026, Arlinda të lutem shkurtimisht një informacion për këshilltarët. Sekretarja e Këshillit- përshëndetje edhe njëherë të gjithëve, ashtu siç jeni njohur me materialin që keni pasur të shpërndarë, ju bëj me dije në lidhje me një informacion për vendimet e miratuara në mbledhjen e muajit Janar, ku ju keni miratuar gjithësej 5 vendime të Këshillit , nga të cilat 2 prej tyre ishin vendime me karakter normativ dhe ne i kemi dërguar në Prefekturë për verifikim ligjor. Sekretarja përmend vendimet normative. Të dy vendimet normative janë miratuar nga Prefektura. Pastaj ju e dini që të gjitha vendimet shpërndahen nëpër zyrat që u takojnë për ti zbatuar.

3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak.

Kryetari- gjithashtu të nderuar këshilltar bashkë me materialet, projekt-vendimet e kësaj mbledhje, ju jeni njohur dhe me procesverbalin e mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak, ndaj unë ju ftoj që të votojmë procesverbalin e mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak. Kryetari hedh në votim procesverbalin e mbledhjes së kaluar dhe miratohet unanimisht me 12 vota pro. Kryetari- me të gjithë votat pro miratohet procesverbali i mbledhjes së kaluar, faleminderit.

4. Për dhënien e Ndhmës Ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për periudhën 1-31 Janar 2025.

Leksi- Kryetar për sa kohë që ne kemi rënë dakort që nuk ka shtesa, nuk ka ndryshime në këtë projekt-vendim, quhet e ezauruar si pikë. Kryetari- ok, atëherë nuk kemi pyetje dhe diskutime?

Leksi- si grup i këshilltarëve nuk kemi.. Kryetari- atëherë në këto kushte ju ftoj të nderuar këshilltar të votojmë projekt-vendimin “Për dhënien e Ndihmës Ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për periudhën 1-31 Janar 2026”. Kryetari hedh në votim projekt-vendimin sipas materialit të paraqitur dhe miratohet unanimitisht me 12 vota pro. Maksi- Afrim mund ti kthej përgjigje Dhuratës? Kryetari- po, fjala është për z.Maksi. Maksi- Kryetarja është nisur për në Tiranë, por për problemin në fjalë pas shqetësimit, ka qënë prezent atje në vend Drejtori i Shërbimeve, Policisë Bashkiake, IMT-së që është këtu dhe Emergjencave Civile Isai, mund të vij tju japi një përgjigje së bashku me mua. Dhurata- sot? Maksi- po sot, të vij Isai tani ta njoftojmë, po ma bëj pyetjen që dhe unë ti them të jetë i përgatitur..Dhurata- jo mund tja bëj dhe atij direkt unë..Maksi- po mbase nuk është i përgatitur..Dhurata- ju keni qënë prezent atje atëherë, faleminderit Kryetar që më dhe kohën. Maksi- mirë dakort për atëherë, edhe për shqetësimin e fundit po them që është bërë, prezent nga ana e Bashkisë ka qënë drejtori..Kryetari- unë them që ta ezaurojmë këtë pyetjen tuaj dhe përgjigjen, po ecim me rendin dhe pastaj..Dhurata- presim dhe Isain..Kryetari- po e bëjmë dhe me rendin e ditës kemi ecur ndërkohë dhe në respekt të rregullores do ishte më e hijshme që ne ecim me rendin e ditës dhe pastaj në pikën e fundit ta diskutojmë. Jemi dakort Dhurata? Dhe në respekt të rregullores për të pasur një rend më të rregullt, ne vazhdojmë me pikat e rendit të ditës dhe në pikën e fundit pastaj e ezaurojmë pyetjen tuaj. Dhurata- jo në pikën e fundit, e duam tani ne se në pikën e fundit..Kryetari- ka të bëj me ndonjë pikë nga ato? atëherë në qoftë së ka lidhje me ndonjë pikë nga këto në atë pikë të lutem, Dhurata më ndiqni? Në qoftë se pyetja juaj ka lidhje me ndonjë pikë të rendit të ditës, tek ajo pikë e diskutojmë..Dhurata- ska lidhje me rendin e ditës, unë e kërkova sikurse gjithmonë juve e keni miratuar çdo kërkesë, një kërkesë të vetme sepse ka të bëj me gjithë komunitetin ku ne jetojmë dhe banojmë..Kryetari- po patjetër pra e miratuar është, tani do që ta ndërpres? Dhurata- nëse vjen Isai më herët..Maksi- sa e njoftova do vij, mbaroni me rendin e ditës..Dhurata- shpresoj që të mos vonohet Isai se unë kisha vetëm 5 minuta kohë, nuk është se kemi kërkuar shpesh herë..Kryetari- po patjetër po, nuk po e diskutojë, po e vë re që unë spo e diskutojë? Dhurata- ok faleminderit, të vij dhe Isai dhe..Leksi- Kryetar në rast se Isai vonohet, ne vazhdojmë me pikat e rendit të ditës dhe në momentin që do vij, është dhe i gatshëm Isai ose dhe specialistët, po marr Isain ose kush është tjetër, e ndërpresim atë pikë të rendit të ditës që kemi dhe le të vazhdojë pyetjen kolegia direkt.

5.Për një saktësim të pikës III në vendimin Nr.05 datë 29.01.2026 “Për miratim fondesh shtesë në buxhetin e Bashkisë Roskovec për vitin 2026”.

Kryetari- ftoj Orgesën për të na dhënë një sqarim se çfarë është ky saktësim që duhet të bëjmë në projekt-vendimin që ne kemi miratuar. Orgesa- të nderuar këshilltar, jam para jush për të prezantuar projekt-vendimin “Për një saktësim të pikës III në vendimin Nr.05 datë 29.01.2026 “Për miratim fondesh shtesë në buxhetin e Bashkisë Roskovec për vitin 2026”. Kjo është një pikë e cila u kalua dhe në projekt-vendimin e kaluar, mori dhe miratimin nga Prefektura dhe thjesht vetëm saktësimi i fondit që vjen nga buxheti i shtetit në vlerën 5,828,911 lekë e cila do të ketë dy financime, do të jetë nga granti i brendshëm dhe granti i huaj. Kjo ishte një pikë shumë e rëndësishme për grantin e huaj, të cilët e donin të specifikuar dhe fondi i cili u kalua dhe u miratua thjesht është bërë në dy nëndarje, në dy burime financimi dhe kjo ka qënë saktësimi i vetëm. Fondi total 5.8 të cilën ne e miratuam ka vetëm dy nëndarje, që vjen 2.6 nga granti i brendshëm dhe 3.2 që është granti i huaj. Dhurata- më fal për cilën pikë e ke fjalën, a jemi te rendi tek pika 5? Orgesa-

po, sistemimi i pikës 3, saktësimi, e keni të miratuar fondin..Dhurata- se e kemi të saktësuar dhe fondin e këtij projekti, sa është fondi i këtij projekti dhe e kemi të ndarë pastaj në fondin e Bashkisë dhe fondi i ardhur nga buxheti i shtetit..Orgesa- po, vetëm këtë gjë kemi ndarë. Dhurata- ok, nëse ske më ti mund të vazhdosh ndonjë pyetje, mundem apo jo? Kryetari- po patjetër fjala është për znj.Dhurata. Dhurata- kur bëhet fjalë për projekte të cilat janë në dobi të komunitetit ku ne jetojmë, punojmë dhe normalisht do kalojmë jetën këtu, sigurisht që janë me shumë vlerë dhe jam me të dyja duart pro, asnjëherë sdo jem kundër por ama jam dakort me ato projekte të cilat zbatohen me cilësinë e duhur, me korrektësinë e duhur dhe kur bëhet fjalë për arsimin, që unë jam pjesë e arsimit kam 31 vite në arsim, dua të jap dhe jetën për arsimin jo më për infrastrukturë dhe gjithçka tjetër që do bëhet konkretisht. Unë jam në shkollën “5 Dëshmorët” Suk 1, në shkollën 9-vjeçare, ajo shkollë si ka bërë 3 vite akoma që është restauruar, po ti vini re muret në klasat e brendëshme kanë rënë komplet, janë gërryer ato gropa-gropa. Nëse nuk e besoni unë kam video këtu tek klasa ime, mos të dalë në klasat e tjera se të gjitha të amortizuara janë, po doni ta shikoni unë e kam vidion dhe ta shikoni, dhe do thoja këtë që po të bëhen këto projekte të hidhen tamam, të zbatohen siç është për tu bërë se është gjynah, është për të ardhur keq sepse atje rrinë jetë njerzish, rrinë fëmijë dhe janë të vegjël. Ato klasat duke rënë, ato muret kanë krijuar lagështi, kanë krijuar mykun. Unë për veten time jam alergjike përdor pompa, por unë nuk dua që ata fëmijë që janë në klasën time, janë 14 fëmijë çdo ditë me mua, 15 me gjithë mua që rrimë në atë lagështi, me atë mykun e saj. Kështu që unë skam asgjë, thashë por po e përsëris viti i 3-të dhe shkollë e re dhe ishte më mirë në gjendjen e mëparshme shkolla jonë atje sesa tani që është katandisur në atë formë. Për çfarë e duam ne atë ngrohjen atje kur klasa po se hape dritaren atje mbytesh nga grasia se komplet faqja anësore e murit është e amortizuar, se kap dot murin se bie copa-copa në tokë, është për të ardhur keq kështu që nuk e di këto projektet, mirë është të jenë sepse kur ja thashë Kryetares që erdhi e pa dhe vet gjendjen në klasën time dhe tha Dhurata se kemi marr përsipër akoma projektin, e tha që vjet, tani e ka marr përsipër Kryetarja atë projekt? Se skanë mbaruar punimet, kur do mbarojnë ato punimet, sa vite? Ndërkohë ne kemi 3 vite që po punojmë atje dhe po jetojmë. Kryetari- fjala është për z.Maksi. Maksi- Dhurata për komentin tuaj, ajo shkollë ju e dini mirë që kemi ardhur e kemi parë, firma që ka pasur punimet ka pasur cilësi të dobët si për palestrën dhe për klasat..Dhurata- palestra është fare..Maksi- me 5%-shin janë bërë të gjitha shkresat, dokumentacioni ligjor dhe ai po vazhdon punimet për të bërë..Dhurata- ska punime hiç atje, unë jam atje..Maksi- po për këtë grasin e thashë, edhe njëherë ka bërë izolimin e palestrës edhe njëherë nga e para, po bën izolimin edhe të mureve, nuk i jepet 5%-shi. Dhurata- më fal nuk është justifikim ai, ata erdhën vjet në këtë kohë, bën sikur e gërryen, e vendosën prapë atë silikonin e bardhë atje ajo përsëri ka rënë, tani ça do të thotë kjo, ça cilësie është kjo? Maksi- nuk e marrim ne në dorëzim e merr supervizori..Leksi- kush firmë e ka bërë? Maksi- nuk të gënjej dot tani për firmë..Dhurata- se nuk e gjejmë dot, është gjynah për të ardhur keq, shkollë e re, nga jashtë godina të merr në qafë, hyn brenda grasi e madhe, muret copë-copë është për të ardhur keq. Shiko të them të vërtetën sepse nuk dua të mohoj gjëra, atje kanë ardhur pelet për ngrohjen, sa e përdorëm gjithsesi hajt se nuk po themi, se disa klasa kanë dhe rezistenca të flasim hapur gjithçka, se ajo që duket skemi pse ta fshehim, por ama lagështi ashtu? Maksi- po dakort pra lagështi por tani është difekt i firmës..Dhurata- edhe ato tualetet atje skanë një ujë të ngrohtë, se ça bëhet, janë prishur thua ngrohjet e shkollës? ti themi këtij, ti themi atij askush nuk mban përgjegjësi, një ujë të ngrohtë skanë pasur fëmijët të lajnë duart atje, mirë ne se po i fshijmë me letra të lagura por ai fëmijë i vogël..Maksi- e thashë në 5%-shin ne jemi interesuar për ta zgjidhur problemin. Dhurata- këto janë

gënjeshtra më duket se asnjëherë nuk janë zbatuar. Kryetari- po fjala është për z.Leksi. Leksi- Kryetar ne kemi një projekt-vendim këtu që duhet ta kalojmë sipas rendit të ditës, nuk diskutohet që shqetësimi i koleges dhe jetojmë me shqetësimin dhe e mbështesim për shqetësimin që ka, jo më kot dhe në mbledhjen paraardhëse që kishim ne kërkuam informacion nga firmat, domethënë si kanë punuar, si skanë punuar dhe këtë e kemi si pikë në fund të rendit të ditës. Unë them që ta kalojmë këtë meqenëse nuk ka diskutime të tjera dhe për shqetësimin e Dhuratës se kam dhe unë pjesë të shqetësimeve për punimet që janë bërë, inxhinierët, supervisorët kush janë ata që kanë ndjekur punimet, të vijmë të na paraqiten..Kryetari- kemi lënë një pikë..Leksi- se nuk është argument jo 5%-shi i mbajtur, 10%-shi, çka kuptimi ka? Kryetari- kemi lënë një pikë sot apostafat për cilësinë e..për pyetjet që ne kemi kërkuar, ndaj ju thashë në fillim të fjalës tuaj që ne kemi kërkuar si këshilltar të majtë dhe të djathtë, duke mos u nisur le të themi nga përkatësia politike, ne kemi kërkuar këtu që të ketë një përfaqësues nga Drejtoria e Investimeve pikërisht, pra ne sot kemi kërkuar këtu që të diskutojmë një nga një projektet sepse shumë këshilltar kishin mëdyshje dhe në raport me cilësinë e punimeve. Atëherë do ju lutem nëse mund të vazhdojmë, ishte i qartë relatimi i kësaj pike të rendit të ditës? Leksi-po. Kryetari- atëherë ju ftoj të nderuar këshilltar të votojmë projekt-vendimin “Për një saktësim të pikës III në vendimin Nr.05 datë 29.01.2026 “Për miratim fondesh shtesë në buxhetin e Bashkisë Roskovec për vitin 2026”. Kryetari hedh në votim projekt-vendimin sipas projekt-vendimit të saktësuar dhe shpërndarë në fillim të mbledhjes dhe miratohet unanimitet me 12 vota pro. Kryetari-me 12 vota pro miratohet ky projekt-vendim.

6. Për miratimin e vlerës maksimale të subvencionimit të qirasë dhe nivelit të qirasë mesatare në tregun e lirë për vitin 2026.

Kryetari- presim specialisten, do ju lutem në mënyrë të përmbledhur të na thoni se çfarë është, me fjalët e tua më shumë sesa me çka kemi lexuar nga relacioni. Specialistja e strehimit Xhuljana- të nderuar këshilltar, atëherë janë llogaritur vlerat mesatare të qirase për gjithë territorin e Bashkisë, të apartamentit garzoniere 100..Maksi- janë llogaritur vlerat mesatare për çdo apartament..Xhuljana- po, për garzoniere 100, apartament 1+1 120, apartamenti 2+1 150 dhe apartamenti 3+1 170, janë vlerat mesatare të tregut të lirë në të gjithë territorin e Bashkisë. Jorgo- sa kanë aplikuar? Xhuljana- për subvencionim qiraje kanë aplikuar 8 aplikant por nga këta 8 aplikant vetëm 3 aplikant kishin dosje të rregullt të cilët kishin kontratën e qirasë, të tjerët nuk e kishin kontratën e qirasë. Jorgo- kur është dhënë ky informacion, që njerëzit janë në dijeni për këtë? Xhuljana- është bërë thirrje në 17 Janar. Jorgo- çfarë thirrje, kujt i thirrët? Xhuljana- është publikuar..Jorgo- ku, në kë? Xhuljana- në faqen e Bashkisë..Jorgo- po njerëzit nuk janë të informuar..Xhuljana- për subvencionim qiraje është afishuar tek këndi i afishimit të Bashkisë..Jorgo- aty tek këndi? Xhuljana- po te këndi..Jorgo- po njerëzit që janë në bujqësi dhe në atë kur do ta marrin vesh? Maksi- Gogo ka një specifikë..Jorgo- kush je ti? Maksi- po mund të ndërhyjë..Jorgo- jo ske, unë po flas me atë..Maksi- për ta plotësuar..Kryetari- të lutem Gogo..Jorgo- kush je ti, prit unë po flas me atë, ti çfarë roli ke? Kryetari- o Maksi nuk duhet ti ndërhysh këshilltarit sa të mbarojë mendimin, vetëm Gogo pak më i përmbledhur..Jorgo- jo ore, kush je ti që po më ndërhysh? Maksi- ndjesë..Jorgo- unë po flas me atë specialisten..Maksi- po ndjesë thashë çka do më, do vazhdosh më pastaj? Kryetari- o Maksi të lutem..Jorgo- jo, do ti të vazhdojë unë? po deshe ti vazhdojë unë..Maksi- unë po them ndjesë..Jorgo- edhe unë e mbylla, po i bëj pyetje specialistes, apo mos ti bëj? Maksi- atë që nuk përgjigjet ajo përgjigjem unë, e kam për

detyrë. Jorgo- ore nuk e dua nga ty, e dua nga specialistja. Kryetari- të lutem të vazhdojmë, z.Gogo mund tja bësh pyetjen, po pyetjet..dëgjo do të lutem ti kursejmë komentet, bëja pyetjet, ato pyetjet sepse i gjej të drejta, që ti japim përgjigje një nga një..Jorgo- tani të flasim apo mos të flasim? Kryetari- urdho, më vjen keq pra..Jorgo- nuk dua të debatojë me ty, as me një..Kryetari- po ske pse debaton, jemi për të diskutuar, urdho pyetja..Jorgo- tani njerzit që nuk janë të informuar, ka shumë nevojtar që nuk e dinë dhe janë në emergjencë, nga do marrin informacion këta njerëz? Xhuljana- kjo thirrje është publikuar në webin e Bashkisë, në rrjetet sociale dhe tek këndi i afishimit..Jorgo- dakort ju keni ato të tuajat por e quajë si të paplotë unë, se ja tek janë të gjithë këta e quajnë të paplotë këtë informacion, megjithatë po shikoj dhe në pikat e tjera që ju i keni plotësuar, i keni bërë të gjitha në rregull, i keni ndarë dhe shtëpitë apo jo? Maksi- nuk është ndarje shtëpie..Xhuljana- është subvencionim qiraje..Kryetari- faleminderit, fjala është për Dhuratën. Dhurata- unë doja të bëja një pyetje, ku ndodhen këto banesa? Ku do gjenden sepse ato janë të specifikuar 10, 120 kjo, 150 kjo, 170 3+1 sa ishte ajo se lexova shumë qartë..Xhuljana- janë banesa në tregun e lirë..Dhurata- më fal ku? Xhuljana- banesa në treg të lirë..Dhurata- ku të gjejnë? Në bazë të tyre pastaj është subvencionimi apo jo? Maksi- tani këto janë banesa me qera që është kontaktuar, është marr kontakt me Njësitë Administrative, me Kryetarët e Njërive, me Këshillat Vendor të Roskovecit, kemi marr kontakte dhe me qiramarrësit e shtëpive këtu në Roskovec, qoftë edhe jashtë Roskovecit por spara ka jashtë Roskovecit që të kenë marr shtëpi me qera. Meqënëse është një projekt që ofron lekë për këta njerëz që kanë marr shtëpi me qera, ne i kemi marr të gjithë, kemi bërë gjithë studimin dhe jemi munduar që edhe njerzit ti njoftojmë. Ata që kanë kontrata me noteri i jemi drejtuar për të sjellë kontratat me noteri me qëllim që ti ndihmojmë. Dhurata- më fal kush i ka kontratat, vërtet dua të marr një informacion..Maksi- po, listën e ke aty, nga 8 kërkesa 3 kanë kontrata me noteri me pronarët e ndërtesave, këtë treshe po diskutojmë tani bashkë. Kryetari- Dhurata përpara se të na sqarojë Eneida, besoj se do të ketë më shumë informacion në lidhje me këtë pikë, se edhe unë kam disa pikëpyetje. Eneida të lutem në sqarimin tuaj mund të më thuash kur, në çfarë date ishte bërë shpallja? Eneida- në 17..Kryetari- 17 deri në 20, mendoni se është koha e mjaftueshme që qytetarët të marrin dijeni dhe të plotësojnë dokumentacionin për të bërë kërkesën? Eneida- çdo vit në Janar bëhet shpallja, çdo vit në Janar dhe ky është viti i 9-të dhe qytetarët e dinë që bëjnë kërkesat për restaurimin e banesave..Dhurata- jo është tjetra ajo..Kryetari- jo po flisim për banesat me qira..Eneida- është i njëjti program por sivjet ne kemi shtuar edhe subvencionin e qirasë. Subvencioni i qirasë vjen njëkohësisht me restaurimin e banesave si shpallje nga Ministria. Përderisa ne e kishim si thirrje të re që do të aplikojmë, në fund të Janarit do shpallej thirrja dhe ne u interesuam në Ministri që a mund të aplikojmë me këtë? dhe na thanë që dërgoni një shkresë, një shprehje interesi paraprak sepse ne na ka ardhur në 30 Janar nga Ministria thirrja dhe ne kemi bërë dy javë para shpalljen që në 30 Janar ne ta dërgonim dosjen e plotë, të mbyllim procedurën, të vazhdonim me procedurën tjetër, pra ne këtë është një kohë që e kemi fituar vet, nga 17-ta deri në 29 sa e kemi lënë..Dhurata- po shumë pak ditë..Eneida- aq na ka lënë dhe Ministria, na e ka lënë afatin e fundit pasi ka sjellë shkresë në datë 30, na e ka lënë në datën 16, domethënë 2 javë kohë kemi patur që ne të bënim gjithë procedurën. Dhurata- shumë e shkurtër, njerzit skanë informacion fare. Kryetari- fjala është për ju z.Jorgo. Jorgo- sa është fondi dhe sa kanë përfituar, sa veta? Dhe pse ky fond mos të investohet në zonën tonë, dhe ku është shkruajtur që u jepet mundësia atyre që të aplikojnë e të gjejnë këto, fondi është i madh dhe aplikimet janë të vogla? Ky veprim po bëhet për herë të parë sivjet, vjet më thuaj një individ që ka përfituar, që ka marr bonus për..më thuaj një individ që ka marr bonus? Kryetari-

si projekt është bërë dhe vitet e tjera por si zë projekti..Jorgo- e kush ka përfituar më thuaj një, më thuaj një individ këtu në Bashkinë tonë që ka marr, që ka përfituar nga ky fond? Eneida- programi për ti ndihmuar familjet në nevojë është një thirrje që e shpall Ministria e Financës dhe ka disa drejtime, dhe ne ndryshe nga çdo vit për 9 vite që kemi fituar dhe kanë fituar shumë reataurimin e shtëpive, sivjet ne futëm edhe subvencionin e qirasë. Jorgo- për herë të parë po bëhet? Eneida- po, për subvencionin e qirasë po dhe akoma nuk e kemi të konfirmuar që do ta marrin, ne thjesht kemi aplikuar në Ministri..Jorgo- dhe keni përzgjedhur..Eneida- jo nuk kemi përzgjedhur, ne në bazë të dokumentave..Jorgo- komisioni është ngritur? Eneida- po është ngritur komisioni dhe në bazë të dokumentacionit që kanë sjellë, sipas kushteve dhe kriterëve kanë dalë këta 3 persona. Kryetari-atëherë që të jemi pak më të qartë se duket se devijuar pak dhe kemi shkuar nga pika 6 tek pika 7..Dhurata- po kanë dhe lidhje ato..Kryetari- ato kanë lidhje por do doja që diskutimin ta bënim tek pika përkatëse. Momentalisht në varësi të studimit që ka bërë grupi i punës, ka paraqitur këtë tabelë..Dhurata- grupi i komisionit, komisioni i ka vendosur këto tarifata? Kryetari- po ka bërë një studim besoj në lidhje me nivelin e qirasë..Dhurata- shoh apartamente 1+1, 1+2, garzoniere..Kryetari- atëherë kjo përcakton vetëm nivelin, përcakton vetëm nivelin e qirasë të cilat do të rimburohen, kështu që e miratojmë projekt-vendimin për miratimin e vlerës maksimale dhe pastaj diskutimin e lëmë për tek pika..Dhurata- unë jam ende e paqartë, këtu thotë çmimi mesatar në zonat rurale ndërkohë thotë banesa me qira për apartament 1+1 është 12 mijë lekë, nga ana tjetër është 7 mijë lekë, kjo 7-mishe çka do të thotë tani, këtu subvencionohet? Eneida- çmimi mesatar në zonat urbane banesa me qira garzoniere është 10 mijë lekë të reja dhe informacionin për në zonat rurale në fshat nuk e kemi se nuk ka, kurse për banesat 1+1 në qytet është 12 mijë lekë dhe në fshat është 7 mijë lekë..Dhurata- këtë 7 mijë lekëshen dua të di unë, si është, çka do të thotë? Eneida- do të thotë që është bërë një studim tregu sa është fakti sot, sa ka paguar një person për një shtëpi 1+1 në fshat, vetëm sa paguan..Dhurata- dhe më fal tani, kjo vlera 70 mijë lekë do ti subvencionohet për gjithë vitin apo jo? Eneida- jo, ky ishte një kusht nga thirrja që ne duhet të miratonim një mesatare të qirasë, që të dinim sa ishte mesatarja dhe në bazë të kësaj mesatare vet Ministria përcakton çka fondi do ti japi personit në qoftë se ata shpallen fitues. Kryetari- besoj se u ezaurua, kërkon dikush fjalën për pyetje tjetër apo për diskutim? Nuk ka. Kryetari- ju fitoj të nderuar këshilltar të miratojmë projekt-vendimin “Për miratimin e vlerës maksimale të subvencionimit të qirasë dhe nivelit të qirasë mesatare në tregun e lirë për vitin 2026”. Kryetari hedh në votim projekt-vendimin sipas materialit të paraqitur dhe miratohet unanimisht me 12 vota pro. Kryetari-me të gjithë votat pro miratohet ky projekt-vendim.

7. Për miratimin e listës së familjeve dhe individëve, që përfitojnë subvencionin e qirasë.

Eneida- pasi është shpallur thirrja në rrugët zyrtare të Bashkisë, janë aplikuar, kanë ardhur 8 të interesuar për subvencion qiraje, nga dokumentacioni që kanë sjellë vetëm 3 plotësojnë kushtet për të vazhduar, që do të thotë kushti kryesor që të kishin një kontratë qiraje nuk e kishin të tjerët..Në sallë ka diskutime midis Jorgos dhe Nënkryetarit Maksit. Kryetari- të lutem o Gogo të flasim pak..Jorgo- po jo se ndërhyt ai..Kryetari- ai ndërhyt po por edhe juve ndërhyt, të flasim pak qartë dhe me etikë se edhe të merret vesh edhe të mbajmë shënim..Jorgo- po dakort por kur ndërhyt ai do ti kthej përgjigje..Kryetari- unë kam një pyetje, z.Maksi ju lutem..atëherë unë kam një pyetje, besoj kriteret mbi të cilat është miratuar kjo listë familjesh i janë referuar udhëzimit apo keni ndonjë udhëzim të veçantë të Ministrisë kur është shpallur thirrja? Eneida- përveç kriterëve

termave të referencës që ka thirrja bashkëlidhur, ajo është baza që bazohet komisioni për të vlerësuar, por përjashtuese ishte kontrata që në rregull mund të bëhej diçka tjetër për të sistemuar por kontrata ishte përjashtuese edhe pse ne, gocat e strehimit janë përpjekur dhe i kanë njoftuar që të lidhnin kontratën gjatë kësaj 2 javorshit që kishin..Kryetari- pra ju është lënë kohë qytetarëve që të sjellin kontratat e noterizuara dhe nuk kanë mundur..Eneida- po patjetër, të 8-të ata që kanë aplikuar janë njoftuar, janë marr në telefon, me shkresë..Kryetari- faleminderit, atëherë fjala për Leksin. Leksi- këta të 3 që janë, janë përfitues apo do shkojnë në Ministrinë e Financës dhe atëherë përfitojnë ose nuk përfitojnë? Sepse këtu ka vendosur një komision i cili ka parë kriteret, i ka parë të arsyeshme domethënë që janë përfitues. Tani ç'a të jetë shkruar, nuk e dimë se ç'a do ndodhi andej, si mund të përjashtohen ? ç'a mundet të ketë ndonjë kriter shtesë atje që mund ti përjashtojnë këta? Eneida- po përshembull çfarë na ka përjashtuar ne në vitet e mëparshme kanë qënë të ardhurat për frymë në zonën e Roskovecit që nuk ishte publikuar në Instat para se ne të aplikonim, është publikuar më pas dhe kur e kanë marr ata në konsideratë, llogarisin të ardhurat për frymë që e përfitojnë dot për kaq anëtar sa janë në familje apo jo? ose ata kanë formulën e tyre që sa mund të subvencionojnë ata, se nuk është e thënë e gjithë shuma, mund edhe 20% mund te subvencionojnë, edhe 50% ..Leksi- sa bën puna dhe gjithë ai angazhim nuk bën shuma që do subvencionohen, kot sa hapim sherr kot ne këtu..Jorgo- tani ne na vijnë 3 pika që janë bashkangjitur njëra pas tjetrës. Ne si Këshill nuk ishte e mundur që të informoheshim për këtë kërkesë që ka ardhur nga Ministria, por na jepen vetëm emrat dhe të votojmë pa ditur kriteret, pa ditur çfarë kriteresh janë si Këshill, ama ju e keni mbaruar punën si Bashki..Eneida- thirrja publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave..Jorgo- po ne si Këshill? Eneida- na ka ardhur ne, patjetër që mund ta keni..Jorgo- na ka ardhur ne si Këshill për miratimin e kriterëve të..? Eneida- por ajo është, janë termat e referencës për Bashkinë që të bëj punën..Jorgo- ne kemi vetëm të ngrejme dorën por keni firmosur ju se ka shumë emra këtu, çfarë keni firmosur ju, çfarë keni vulosur apo jo? Vetëm të ngrejme dorën pa ditur as fondin, as kërkesat që kanë bërë, vetëm të ngrejme dorën..Eneida- përse i përketë fondit, fondi është në bazë të aplikimeve që ne kemi, nuk kemi një fond limit nga këtu deri këtu, në qoftë se do kishim 10 aplikime do çonim 10 aplikime të sakta, ne kemi çuar dhe 15 banesa, kemi çuar dhe 5..Jorgo- jo nuk e kam unë përshtypjen se çfarë keni bërë ju, ju keni bërë punën tuaj, u ka ardhur e keni punuar, por ne si Këshill jemi vetëm të miratojmë çfarë komisionet të gjitha gjërat, vendimet që keni marr ju pa e ditur se çfarë kritere janë këto, direkt në votim? Kryetari- po kërkon informacion mbi kriteret që janë përdorur se spo..? Shiko grupi i punës po thotë që është bazuar mbi kriteret që parashikon thirrja në lidhje me këtë projekt-vendim dhe bazuar mbi atë ato kanë hartuar këtë listë, juve ju duhet..Jorgo- jo nuk kam vërejtje për grupin se ç'a ka punuar, po ne si Këshill duhet të na vinin këto kritere ti miratonim apo jo? apo të shtonim diçka? Ska kompetencë Këshilli të miratojë këto? Maksi- po më pyete mua që po më shikon në sy unë të kthej edhe përgjigje..Jorgo-unë spo të shikoj në sy as kam pse të shikoj në sy ty dhe asnjërin, unë po flas..Maksi- thashë po më pyete do të kthej përgjigje..Jorgo- jo atë e ka Kryetari, që ai e jep atë fol ti apo fol unë, dhe kur kërkoj unë..Kryetari- të lutem tani, të lutem që të marrësh përgjigje tani..Jorgo- po Kryetari e drejton atë, kush do japi përgjigje apo jo? Kryetari- patjetër, të marrësh përgjigje, të lutem Maksi a mundet..Dhurata- o Kryetar më fal, ndoshta kolegu po kërkon thjesht një përmbledhje, a ka patur kritere ose do të njihet me kriteret shkurt mos të hallakatemi kot..Eneida- kriteret janë specifike për çdo program dhe mund të jenë diku tek 30 faqe..Dhurata- po shkurtimisht 2-3 gjëra nuk i thua dot, smundesh? Eneida- po kjo ishte një nga këto..Dhurata- se ato kërkon Gogua..Eneida- e kuptoj por unë nuk mund të gaboj tek ato që do them sepse kriteret janë

kritere dhe një nga kriteret penalizuese ishte kontrata tek ky rast..Maksi- jo penalizues por kusht kryesor që për të përfituar qiranë duhet të ketë kontratë të noteruar midis pronarit dhe qiramarrsit, pa këtë gjithë të tjerat janë të hedhura poshtë. Kemi shumë sot fëmijët tanë që janë në Tiranë e të tjera me radhë që kanë shtëpi me qera por nuk kanë bërë kontratë te noteri dhe nuk e përfitojnë asnjë lloj..Dhurata- dhe janë në të zezë..Maksi- po është në të zezë, këtu përfitojnë vetëm ata që janë të legalizuar tek noteri..Dhurata- kontratat nuk bëhen në Tiranë jo të bëhen në Roskovec. Maksi- po tani kur sbëhet dhe ne skemi mundësi se është kusht vendimtar, pa kontratë nuk mund të marrësh bonus qiraje..Dhurata- mesa kemi dëgjuar në Tiranë 99% janë kështu pa kontratë..Maksi- prandaj po them, ndaj dhe ne si komision, e falenderoj antarin e Këshillit tani që tha komisioni ka punuar dhe vërtet ka punuar, ka vajtur në çdo shtëpi që është me qera e të tëra me radhë, sipas informacionit që kemi nga kryetarët e fshatrave qoftë dhe nga Këshilli drejtues këtu..Dhurata- keni ndonjë rast në Suk, keni raste? Maksi- po edhe njëherë, kemi vajtur në shtëpi dhe nga 8 raste që ne gjetëm me qera, 3 plotësojnë kriteret dhe kriteri themelor është ky, ndërsa kriteret pastaj për të mos kaluar dhe mos diskutuar më tej, janë kritere që janë dhe për riparimin e shtëpive në nevojë për personat që janë me ndihmë ekonomike..Jorgo- po në këtë pikë nuk është riparimi i shtëpive..Maksi- janë dhe thashë, e shtova. Kryetari- ka dikush tjetër pyetje? Për diskutim e kërkon dikush nga ju fjalën? Pyetje dhe diskutime nuk kemi, të nderuar këshilltar ju ftoj të votoni projekt-vendimin “Për miratimin e listës së familjeve dhe individëve, që përfitojnë subvencionin e qirasë”. Kryetari hedh në votim projekt-vendimin sipas materialit të paraqitur dhe miratohet me 10 vota pro, 2 vota abstenim Dh.Malka, J.Begaj. Miratohet.

8. Për miratimin e listës së përfituesve nga programi “Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara”.

Kryetari- do vazhdoni ta relatoni ju besoj? Eneida- po. Kryetari- në mënyrë të përmbledhur, më mirë me fjalët e tua sepse relacionin besoj që e kanë marrë..Leksi- të njëjtat pika, plotësojnë njëra-tjetrën. Eneida- po programi është i njëjtë, siç kemi aplikuar çdo vit ky është viti i 9-të që aplikojmë për përmirësimin e kushteve të banimit për familjet në nevojë, është ndjekur e njëjta procedurë, janë njoftuar administratorët dhe kryetarët e fshatrave që të bëjnë edhe ata propozimet e tyre, është shkuar në terren janë parë të gjitha banesat, komisioni ka dalë..Dhurata- më fal Kryetar, mendoj që ta nërpresim sepse e dimë situatën, mos të zgjatemi..Kryetari- ok, nuk ka nevojë dikush që të drejtojë një pyetje? Po fjala është për z.Leksi. Leksi- drejtoreshë më dëgjon, më para meqë ka patur një numër të madh përfituesish tani kemi më pak, do të thotë që kushti kryesor këtu duhet të jetë çertifikata e pronësisë, për të cilën pjesa më e madhe këtu dhe këtu është thembra e Akilit, komplet e të gjithëve dhe jo e bashkëqytetarëve tanë atje që nuk e kanë, prandaj është dhe numri i paktë i atyre..Eneida- kjo është arsyeja e parë dhe arsyeja e dytë është kusht që familjet të jenë me ndihmë ekonomike. Leksi- po, për të tjerat jam qartësuar, di që keni bërë dhe një punë të mirë dhe me këta përfituesit. Unë si grup mendoj se duhet ta kalojmë. Kryetari- mirë faleminderit, për diskutim e kërkon dikush fjalën? Nuk ka. Kryetari- ju ftoj të nderuar këshilltar të votojmë projekt-vendimin “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi “Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara”. Kryetari hedh në votim projekt-vendimin sipas materialit të paraqitur dhe miratohet unanimisht me 12 vota pro. Kryetari- me të gjithë votat pro, 12 vota miratohet ky projekt-vendim, ju falenderoj për votimin.

9. Për miratimin e bashkëfinancimit për programet e strehimit social, fond i miratuar me VKB Nr.71 datë 24.12.2025 “Për miratimin e dokumentit përfundimtar të PBA 2026-2028 dhe buxhetit të vitit 2026”.

Kryetari- do ju lutem edhe juve..Orgesa- po, që ta përmbledh..Kryetari- po dhe mundësisht në një mënyrë sa më të kuptueshme nga qytetarët, jo thjesht në gjuhën e përdorur në relacion. Orgesa- në lidhje me dy programet e strehimit..Dhurata- Kryetar më fal, meqënëse ne jemi njohur me materialet, nuk e di çka do bëj grupi tjetër por..Maksi- po, miratuar dhe listën ju..Sekretarja- po, ka lidhje me listën. Kryetari- atëherë në kushtet që këshilltarët janë të njohur me relacionin dhe kanë krijuar bindjen e vet në lidhje me këtë projekt-vendim, ju ftoj të nderuar këshilltar të votojmë projekt-vendimin “Për miratimin e bashkëfinancimit për programet e strehimit social, fond i miratuar me VKB Nr.71 datë 24.12.2025 “Për miratimin e dokumentit përfundimtar të PBA 2026-2028 dhe buxhetit të vitit 2026”. Kryetari hedh në votim projekt-vendimin sipas materialit të paraqitur dhe miratohet unanimitisht me 12 vota pro. Kryetari- me 12 vota pro miratohet ky projekt-vendim, duke ju falenderuar për votimin, faleminderit dhe Orgesës që ishte e pranishme.

10. Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Bashkisë Roskovec dhe Ndërmarrjes vartëse.

Orgesa- për shkak të ndryshimit të pagës minimale nga 40 mijë lekë në 50 mijë lekë në shkallë vendi dhe indeksim të pagës, është bërë rritja e pagave të cilat kanë qënë nën nivelin 50 mijë, nga 50 deri në 57 mijë, pozicionet e tjera flasim për Bashkinë Roskovec në nivel specialist, përgjegjës dhe drejtora nuk ka asnjë ndryshim. Ndërkohë përsa i përketë Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike është bërë një ulje e nivelit të pagave vetëm për pozicionet drejtuese, drejtorët dhe përgjegjës. Nivel specialist dhe pozicione të tjera nuk kanë ndryshim përveç pagës minimale. Kjo mbulim i diferencave i rritjes së pagave bëhet nga buxheti i shtetit, gjithashtu dhe nga të ardhurat e Bashkisë. Dhurata- më fal pak, sikur e dëgjova që kishte dhe ulje të pagave? Orgesa- po, për Bashkinë drejtora, përgjegjës dhe specialist nuk kanë ndonjë ndryshim, vetëm është rritja e pagës minimale nga 40 në 50..Leksi- është VKM..Orgesa-po, përsa i përketë ndërmarrjes vartëse pastaj është bërë një ulje e pagave vetëm në pozicionet drejtues, drejtor dhe përgjegjës kanë një ulje të vogël të nivelit të pagave..Dhurata- po pse? Orgesa- pasi kjo rritja e madhe nuk mund ta përballonte dot Bashkia me fondin që erdhi, kështu që u detyruam që të ulnim pagat vetëm për drejtuesit, drejtor-përgjegjës. Kryetari- kërkon dikush fjalën për pyetje? Leksi- sa është efekti që arritet dhe ja ulët pagat atyre drejtuesve të ndërmarrjes vartëse dhe sa na ndihmon neve? le të qëndrojmë aq sa ishte..Dhurata- jo ata ashtu e kanë parë të arsyeshme..Orgesa- nga ndryshimet e pagave në nivel drejtues, bëhet fjalë për një fond 1 milion të reja kështu që pjesa tjetër 14 milion do mbulohej nga të ardhurat e trashëguara të Bashkisë që do të na jepen për këtë rritje të pagës dhe pjesa tjetër vjen nga buxheti i shtetit. Leksi- mirë por më kupton më ngjan si diskriminuese ti drejtoreshë, që ulet paga e drejtuesve andej dhe pagat e drejtuesve këtu janë në vend, më kupton? Dhurata- pse të duket diskriminuese ty, po ja ne arsimtarëve përshembull na premtuan dhe sna e ngriti njeri rrogën, ne sjemi të diskriminuar ne arsimtarët? Leksi- tani ne po flasim për pozicionet në Bashki ti Dhurata, spo flasim për arsimin këtu..Në sallë ka diskutime midis Leksit dhe Dhuratës. Kryetari- z.Leksi mos të përfshihemi në diskutime të panevojshme..Orgesa- Leksi mund të shtoj këtu që është parë volumi i punës që bën një drejtues..Leksi- a tjetër gjë volumi i punës, se të ardhurat që nuk përballon është tjetër gjë, në rregull. Orgesa- në krahasim me një drejtues të ndërmarrjes është parë

e arsyeshme që të bëhet kjo ulje. Leksi- në rregull, jam shumë i qartë drejtoreshë. Kryetari- atëherë faleminderit, besoj se ju e morët përgjigjen, dikush tjetër kërkon fjalën për pyetje apo diskutim në lidhje me këtë projekt-vendim? Nuk ka. Kryetari- në këto kushte ju kërkoj të nderuar këshilltar të votojmë projekt-vendimin “Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Bashkisë Roskovec dhe Ndërmarrjes vartëse”. Kryetari hedh në votim projekt-vendimin sipas materialit të paraqitur dhe miratohet unanimitisht me 12 vota pro. Kryetari-me 12 vota pro miratohet ky projekt-vendim, faleminderit.

11. Për shtesë fondesh nga të ardhurat e trashëguara në buxhetin e vitit 2026.

Jorgo- ta kalojmë se jemi në dijeni, kaloje në votim. Kryetari- meqënëse nuk kemi pyetje në lidhje me relatimin e këtij projekt-vendimi në tërësi dhe për diskutim nuk e kërkon njeri fjalën, atëherë ju lutem të dëgjojmë drejtoreshën. Orgesa- doja tju sqaroja për diçka, doja të përmendja se kemi shtuar një projekt të ri, i cili nuk ishte në dokumentat që ju keni dhe ka të bëjë në lidhje me relacionin për projekt-vendimin “Për shtesë fondesh nga të ardhurat e trashëguara në buxhetin e vitit 2026”. Kemi shtuar një projekt të ri që është “Qeverisja e mirë përmes pjesmarrjes aktive në bashkëfinancimin e projekteve” e cila do të ketë një fond të përcaktuar në 3 milion lekë dhe materiali që sapo ju shpërndava, informacioni dhe udhëzuesi ka të bëjë pikërisht me këtë pikën 3 në këtë projekt. Nëse doni tju jap një informacion shkurtimisht, Bashkia Roskovec do hapi një thirrje..Jorgo- çka bëjnë këta, këto fonde që kanë shtuar..Kryetari- nuk ka shtuar fond..Orgesa- nuk kam shtuar fond, është nga të ardhurat e trashëguara dhe thjesht do ta përdorim për këtë projektin. Kemi menduar që të bëjmë një projekt të mirë për komunitetin me bashkëfinancim nga vet qytetarët ose individët, ose organizata jofitimprurëse dhe gjithë informacioni që ju vura në dispozicion, udhëzuesin e informacionit të përmbledhur, ka të bëjë me këtë projekt. Kryetari- të nderuar këshilltar ju ftoj të votojmë projekt-vendimin “Për shtesë fondesh nga të ardhurat e trashëguara në buxhetin e vitit 2026” me ndryshimin shtimin e pikës 3 tek planifikimi për financim dhe projekte të tjera. Kryetari hedh në votim projekt-vendimin bashkë me shtesën e bërë të pikës 3 tek relacioni dhe miratohet unanimitisht me 12 vota pro. Kryetari-me të gjithë votat pro miratohet ky projekt-vendim.

12. Për miratimin e raportit për vlerësimin dhe parashikimin afatmesëm të të ardhurave 2027-2029.

Drejtori i të Ardhurave Vendore Selmani- u paraqesim këtë projekt-vendim për miratimin e raportit për vlerësimin dhe parashikimin e të ardhurave afatmesme 2027-2029, i cili ka të bëjë me fillimin e punës për projekt buxhetin afatmesëm 2027-2029. Bazë për këtë raport që ju paraqesim është padyshim ligji 139/2015, ligji për taksat dhe tarifave vendore, udhëzimet përkatëse në zbatim të tyre si në drejtim të miratimit të PBA ashtu dhe të taksave dhe tarifave, programimit të tyre si dhe vendimi i Këshillit të Bashkisë Nr.70 datë 24.12.2025 “Për miratimin e paketës fiskale për vitin 2026”. Këtu kemi paraqitur raportin e plotë dhe të imtësishëm, domethënë për çdo lloj të taksave dhe tarifave vendore duke u bazuar në realizimin e dy viteve të mëparshme, vitit në të cilin jemi dhe 3 vitet në vazhdim 2027-2029, i cili përbën projekt buxhetin afatmesëm PBA. Kjo do të jetë fillimi i punës siç e thashë për këtë projekt buxhet 2027-2029, në qoftë se doni shifra, metodologjinë e kemi të paraqitur padyshim për çdo lloj takse dhe tarife, mënyrën e llogaritjes dhe të programimit të saj, në qoftë se doni shifra pastaj vazhdojmë ose keni ndonjë pyetje, paqartësi

jam i gatshëm që tju kthej përgjigjet përkatëse. Nazmiu- e kemi shumë të qartë. Jorgo- sjemi shumë të qartë..Selmani- urdho pyet..Kryetari- fjala është për z.Jorgo. Jorgo- hidhe në votim..Kryetari- më thatë që nuk ishit i qartë..Jorgo- lërë se nuk dua të ashtu, radhës tjetër të vijmë ta votojmë..Kryetari- dikush e kërkon fjalën, ka pyetje ndonjë nga këshilltarët për diskutim në lidhje me këtë projekt-vendim? Nuk ka. Kryetari- atëherë ju ftoj të nderuar këshilltar të votojmë projekt-vendimin “Për miratimin e raportit për vlerësimin dhe parashikimin afatmesëm të të ardhurave 2027-2029”. Kryetari hedh në votim projekt-vendimin sipas materialit të paraqitur dhe miratohet me 10 vota pro, 2 vota abstenim Dh.Malka, J. Begaj. Miratohet ky projekt-vendim.

13. Diskutime dhe komente të qytetarëve.

Kryetari- nga mbledhja e kaluar kemi parashikuar që në këtë mbledhje do të ishin të pranishëm dhe një pjesë e administratës, të cilët do ti jepnin drejtpërdrejtë përgjigje pyetjeve të ngritura nga këshilltarët në këtë sallë. Përpara sesa të ezaurojmë këto pyetje, unë do doja që të vazhdonim atje ku e lamë me pyetjet që kishte znj.Dhurata, ftoj z.Isa Hoxha, atëherë pak qetësi. Znj.Dhurata fjala është për ju për të drejtuar pyetjen, Nënkryetari ka zgjedhur që të jetë i pranishëm këtu dhe z.Isa Hoxha. Dhurata- faleminderit Kryetar, unë në fakt e përsëris prapë, thashë mirë ishte të ishte Kryetarja këtu, në mungesë të saj ishte Nënkryetari sepse Nënkryetari ka qënë prezent në një takim publik që është bërë në fshatin Suk 1, kryesisht në lagjen Agaçajve dhe Metushve, tek lokali i Lani Gllavës. Atje kanë qënë pothuajse rreth 100 banorë, kryesisht burra dhe nja 4-5 femra atje përfshirë dhe Kryetaren, dhe normalisht e thirrën vet qytetarët Kryetaren e Bashkisë për, kishin dëgjuar fjalë që do bëhej, që do ndërtohej ky termocentral, ndërkohë dhe u miratua dhe nga Këshilli këtu, dhe këta e kërkuan, më pas u miratua. Tani Kryetarja atje ka thënë dhe Nënkryetari u ka thënë qytetarëve, u ka premtuar hapur që mos kini frikë se ska për tu bërë, ky thjesht ka ardhur si çështje për tu diskutuar në Këshill dhe vetëm kaq. Nëse ju doni fakte unë i kam vidiot, dikush qytetar ma ka nisur vidion, ka folur Kryetarja më shumë se Nënkryetari, se Nënkryetari është marr me publikun andej, por është vidioja e qartë dhe e thotë Kryetarja mos u shqetësoni, rrini të qetë, asgjë ska për të ndodhur, ska për të ndodhur kurrë, nuk do ndërtohet e të tjera me radhë dhe realisht tani është dita e pestë e punimeve, atje kanë filluar punimet ju besoj jeni shumë në dijeni apo nuk e di a sjeni fare në dijeni se në fund të fundit kur një..Maksi- prandaj ka ardhur Isai..Dhurata- ndaj po them unë se tani unë mendoj që Kryetarja e Bashkisë, gjithë stafi i Bashkisë, të paktën Kryetarja dhe Nënkryetari duhet të ishin prezent atje të qetësojnë qytetarët, sepse ata normalisht janë shumë të irrituar dhe nëse do protestojnë i ka mbytur gjithmonë ajo shprehja që shiko çka po ndodh në zonat e tjera të Shqipërisë, kryesisht në Rrjollë të Velipojës në qytetin e Shkodrës, atje çfarë masakrash po i bëjnë qytetarëve, që po i marrin pronat e të tjera me radhë dhe ata janë shumë të frikësuar sepse mendojnë që nëse këta do protestojnë, normalisht protestat do të jenë paqësore por mendojnë se edhe këta do kenë të njëjtin fat sikurse kanë ata qytetarët atje. Tani sa për transparencë ajo tokë atje e kujt ishte e para? Dhe e dyta pse duhet të na shkaktojnë këtë dëm mjedisor dhe të gjitha dëmet e tjera, se ju e dini shumë mirë se jeni të gjithë të arsimuar ju që jeni brenda sallës së Këshillit. Pse filloi ky projekt? Sepse u tha që nuk ka për të filluar kurrë tha Kryetarja..Kryetari- faleminderit znj.Dhurata, fjala është për z.Maksi. Maksi- unë të paktën në dijeni si Nënkryetar i Bashkisë nuk jam për këtë përgjigje të Kryetares për vet faktin se nuk është Kryetarja autoriteti që vendos për ndërtimin e Tecit dhe unë nuk besoj dhe nuk jam absolutisht dakort me ju, që të thotë Kryetarja që nuk do bëhet asgjë dhe nuk do të ndërtohet Teci. Dhurata- të

duhet vidioja apo..Maksi- patjetër, në qoftë se do të duhet vidioja ta ballafaqojmë dhe me vidio këtu ose në vend tjetër..Jorgo- po meqë e nxorre vidion, ballafaqoje me vidio..Maksi- Gogo kush je ti që flet se po përgjigjem unë, tani po ta kthej me të njëjtën monedhë kush je ti, po i përgjigjem Dhuratës, të mbarojë me Dhuratën pastaj..Jorgo- po jo, të paktën pohoje që ne e kemi thënë..Maksi- të lutem unë të kërkoja ndjesë, kërkomë ndjesë që po futesh në bisedën time, në qoftë se do të bësh rrëmujë bëj, kërko ndjesë ashtu si të kërkoja dhe unë ndjesë, tani të lutem..Jorgo- pse i mohon fjalët që ke thënë? Maksi- nuk kam thënë fjalë, të lutem..Jorgo- ke qënë edhe ti atje..Maksi- kam qënë, po mund të kem qënë atje por skam..Jorgo- ske folur ti? Ti nuk ke folur atje? Maksi- ti kthej përgjigje njëherë zonjës, të lutem ti kthej përgjigje zonjës? Kryetari- z.Gogo të lutem që të respektojme njëri-tjetrin..Maksi- Kryetar unë kërkoja ndjesë qëparë, ai duhet të më kërkojë ndjesë që më futet..Jorgo- e mirë, ndjesë edhe unë..Maksi- respekt. Znj.Dhurata nuk është autoriteti i Kryetares së Bashkisë as i Maksit si Nënkryetar Bashkie që të jap atë përgjigje që thatë ju, që nxirrni nga goja juaj, dhe autoritet për të dhënë lejen dhe lejen e ndërtimit dhe shfrytëzimit e të tjera me radhë, nuk jemi ne por është KKRT-ja e Republikës së Shqipërisë..Jorgo- jo ore, e miratua edhe ne si Këshill..Maksi- ne nuk miratua ndërtimin e Tecit..Dhurata- po mirë skeni përgjegjësi fare? Jorgo- ore i bëtë presion të gjithëve, ja tek janë këtu..Dhurata- më fal skeni përgjegjësi fare? Kryetari- z.Gogo të lutem mos ndërhyini më..Maksi- pastaj se çka bëhet atje do të kthej përgjigje që ne pasi morëm shqetësimin..Dhurata- nuk është kompetencë, si nuk është kompetencë? Vjen dikush një person i huaj ndërton në pronën tonë, në shtëpinë tonë dhe ne se dimë? Maksi- edhe njëherë, ashtu siç e the pyetjen unë do përgjigjem për aq sa kam autoritetin dhe kompetencën..Dhurata- po ti po e heq nga vetja komplet sikur sdo tja dish fare, ndërkohë që..Maksi- po tani të lutem, mbarove pyetjen unë do kthej përgjigje, do të kthej përgjigje apo sdo? Dhurata-po patjetër. Maksi- ne për sa morëm shqetësimin e qytetarëve që ka filluar ndërtimi dhe shqetësimin që keni ju si këshilltare..Dhurata- paskeni vajtur..Maksi- po, kemi dërguar drejtorin e IMT-së dhe të Policisë Bashkiake për të marr përgjigjen e saktë të punëve që bëhen atje dhe drejtorin ndaj e thirrëm tani këtu që kërkuat ju, e thirrëm për këtë punë, mund të vazhdosh Isa. Dr. i Emergjencave Civile, IMT-së dhe Policisë Bashkiake Isa Hoxha- përshëndetje të gjithëve, faleminderit Dhuratë në lidhje me pyetjen që ngrite. Në gjithë diskutimin që unë ndoqa me vëmendje, pjesa që na përketë ne si Drejtori të Emergjencave Civile ku është e përfshirë Policia Bashkiake dhe IMT-ja, është vetëm detyrimi për të bërë verifikimin e objekteve që ndërtohen në territorin nën juridiksionin e Bashkisë Roskovec. Në lidhje me punimet që po kryen atje, ne kemi marr njoftimin, ata kanë nisur njoftimin dhe kanë detyrimin që të nisin njoftim vetëm për fillimin e punimeve. Ne kemi shkuar dhe në terren kemi bërë verifikimin, kemi marr edhe shkresat përkatëse, kjo është vetëm kompetenca..Dhurata- cilat shkresa keni marr? Isa- njoftimi i fillimit të punimeve, tabela ishte vendosur, këto që ne kemi të parashikuara me ligj për ta penguar, në lidhje me këto ata i kanë depozituar dhe ne jemi në rregull me shkresat e tyre..Dhurata- çka do të thotë kjo, si je në rregull, vetëm me shkresat je në rregull? Isa- njoftimin e fillimit të punimeve..Dhurata- pse për atë po vuaje ti, për të njoftuar ata patjetër? Isa- vetëm kjo është që i përketë institucionit të Bashkisë së Roskovecit..Dhurata- çka do bësh ti do të dijë komuniteti, çka do bëni ju si Bashki? Isa- nuk të përgjigjem dot për pjesët e tjera..Dhurata- sepse Kryetarja tha që nuk do bëhet, tani doni vidion ta nis, ta dëgjoni? Isa- unë të përgjigjem për këtë që më pyete, faleminderit. Maksi- ke Kryetar Këshilli që të komunikosh..Jorgo- vëre ta shikojnë dhe ta marri ai me kamer se kështu doni..Kryetari- të lutem z.Gogo edhe njëherë të tërheq vëmendjen për mënyrën sesi shpreheni, nuk ka nevojë që të përdorim padrejtësisht..Dhurata- ja mund ta dëgjojmë..Dhurata hap nga telefoni i

saj një vidio dhe e afron tek mikrofoni që të dëgjohet audioja e saj, ku dëgjohet zëri i Kryetares dhe disa zëra të tjerë në sfond, gjatë një takimi të zhvilluar. Dhurata- ndërkohë të nesërmen u votua në Këshill. Maksi- po nuk po thotë që nuk do të ndërtohet, Kryetarja ka thënë që nuk do të ndërtohet e thatë ju..Kryetari- atëherë e qartë, e qartë Dhurata, të lutem z.Maksi. Znj.Dhurata të jemi korrekt dhe në maksimumin e respektit të fjalës tuaj dhe dëshirës tuaj për tu dëgjuar në këtë mbledhje të Këshillit, ne e dëgjuam dhe në ligjëratë të drejtë, ne nuk jemi gjykatë në fakt që të merremi duke parë faktet deri në këto hollësira, por në ligjëratë të drejtë Kryetarja thotë që nesër që i referohet besoj ditës së nesërmë të votimit në këtë Këshill, nuk votohet fakti nëse do të ngrihet ose jo një objekt pasi nuk është kompetencë e Këshillit kjo gjë, por votohet fakti nëse do të ndryshojë kategoria e tokës apo jo dhe këtë e ka thënë ajo dhe nuk besoj se do ta mohojë, nuk ka të bëj..Jorgo- po mirë ne si Këshill çfarë votuam ne si Këshill? Kryetari- në qoftë se nuk e mban mend se çfarë ke votuar, do ti referohesh jo ndërtimin sepse nuk mundet që një Këshill Bashkiak nuk ka kompetencë ligjore që të votojë këtë gjë..Jorgo- lejen për ndërtimin e Tecit kush e dha? Kryetari- lejen KKRT-ja..Jorgo- po ne ç'a miratua? Dhurata- çfarë u miratua këtu në Këshill? Kryetari- në Këshillin tonë u miratua ndryshimi..Jorgo- radhën e parë u kërkua mbledhje urgjente, pse u kërkua mbledhje urgjente? U kërkua vetëm për Tecin dhe ju nuk morët pjesë dhe e ka drejtuar zonja..Kryetari- unë thashë në respekt të asaj zonje unë pranova që në këtë mbledhje të dëgjojmë dhe ajo që ishte e filmuar, ajo që ne kemi votuar dhe miratuar është ndryshimi i kategorisë së tokës jo fakti..Jorgo- po ajo ndryshimi i kategorisë së tokës për ç'a e bëmë ne, për ngritjen e Tecit..Dhurata- më fal, për çfarë ndryshimi e ke fjalën? Ç'a është kjo kategoria e tokës, pse kush ishit ju gjeolog? Nënkryetar me ju e kam fjalën..Kryetari- Këshilli i Bashkisë ka kompetencë..Dhurata- të kujt janë ato fjalë që thua cilësinë e tokës? Jorgo dhe Dhurata flasin njëkohësisht. Kryetari- po a keni qënë ju në mbledhje? Jorgo- po në mbledhje ishim, o Afrim ti nuk ishe, nuk e drejtove ti mbledhjen apo jo? Kryetari- e drejtë, por unë kam pas gjithmonë rendin e mbledhjes dhe projekt-vendimi që ka qënë për tu votuar në këtë Këshill nuk ka pasur të bëj me ndërtimin..Jorgo- çfarë nuk kishim ne, çfarë votuan ne me shtetrrëthim këtu? Kryetari- pra ne ndryshuam planin vendor, i cili përcaktonte zonat që binte plani i përgjithshëm vendor..Dhurata- pse erdhën makina policie këtu që rrethuan Roskvecin? Jorgo- çfarë votuam ne, atë votuam ne planin e përgjithshëm, ore i thërret mendjes ti? Në sallë ka diskutime midis këshilltarëve Leksi, Jorgo, Dhurata. Jorgo- edhe ne do ta vuajmë atë Tec, nuk do ta vuajmë vetëm këta, do ta vuajmë edhe ne. Kryetari- atëherë pasi u ezaurua pyetja e veçantë që kishte znj.Dhurata, do doja tju pyes nëse jeni dakort..Në sallë vazhdojnë diskutimet midis Jorgos dhe Leksit. Kryetari- para se të vazhdojë do ju lutem një përgjigje përfundimtare në lidhje me çështjen e ngritur nga z.Maksi dhe pastaj vazhdojmë. Maksi- Kryetari i Këshillit e tha që në respekt të këshilltarit ne e dëgjuam edhe vidion që nuk është e thënë që të dëgjohet në çdo Këshill Bashkie një vidio e tillë duhet të jemi korrekt, e dëgjuam vidion..Dhurata- jo thjesht për ta dëgjuar se ishit prezent, nuk janë gënjeshtria ky është morali që nuk janë gënjeshtria..Maksi- dhe unë dua të saktësojë që as nga goja e Kryetares së Bashkisë Majlinda Bufi, as nga goja e Nënkryetarit të Bashkisë, as në vidio dhe as atje nuk është thënë që ne jemi të zotët të mos ndërtohet Teci..Dhurata- kush e tha këtë që ne jemi të zotët? Maksi- e thatë ju..Dhurata- nuk do ndërtohet thashë rrini të qetë, se dëgjoje deri në fund ti..Maksi- edhe njëherë nuk ka thënë rrini të qetë po tha në Këshill do kalojë kjo, ndërsa thashë nuk është kompetenca as e Këshillit as e Kryetares së Bashkisë..Dhurata- po rrini të qetë mbase ska thënë, ti nis vidiot ti dëgjosh, ti nis unë mos ki merak, rri i qetë i kam këtu vidiot, mi nisi ai bota që është i interesuar, që e ka shtëpinë atje..Maksi- dakort atë bëj ç'a të duash ti, të paktën ato që thatë ju duhet

të kërkonti ndjesë..Dhurata- çfarë ndjese do kërkojë, për çfarë do të kërkojë ndjesë? Maksi- që thatë që nga goja e Kryetares doli që nuk do ndërtohet..Dhurata- për çfarë, që të vij rendi ty sipas interesit tënd? Maksi- jo sipas vidios që nxorët ju, vidion e dëgjuan të gjithë këshilltarët..Dhurata- po jo pra se nuk e dëgjove deri në fund pra, se dëgjove deri në fund se vidioja vazhdonte, ju filluat bisedën, Kryetari e ndërpreu..Maksi- stë kërkoj njeri për ta çuar deri në fund..Dhurata- a skërkoj njeri, e kërkoj unë pra, janë fakte që thatë nuk do ndërtohet rrini të qetë..Maksi- unë dua së bashku me këshilltarët të them atë që fjala juaj nuk qe e saktë..Dhurata- si nuk qe e saktë fjala ime, sepse të intereson ty kështu bashkë me këshilltarët se i detyrove ta votonin, bëj si të duash zotri por ta dish që je ti fajtor, do mbahesh mend gjatë në histori ti Maksi bashkë me Majlinda Bufin ta kesh të qartë dhe mos më trego mos fol në emër të këshilltarve se këshilltarët ti i detyrove të votonin megjithë Kryetaren. Dhurata largohet nga mbledhja. Kryetari- z.Gogo ju nuk do donit që ti dëgjonit..Jorgo- po çka do dëgjojë? Kryetari- kemi bërë disa kërkesa..Jorgo- të njëjtat gjëra, ja kërkesa po bën 2 vjet që e kam bërë..Kryetari- që ishin në lidhje me cilësinë e punimeve..Jorgo- ore ata spo punojnë fare ti thua cilësi, kërkesat tona..Leksi- ta lëmë njëherë tjetër pastaj, në sallë ka diskutime..Kryetari- z.Gogo për cilësinë e punimeve do të donit që ta shtyjme, ta lëmë për mbledhjen tjetër? Jorgo- e lëmë radhës tjetër. Maksi- ja kjo ishte e gjitha. Jorgo largohet nga mbledhja. Kryetari- do ju lutem të nderuar këshilltar dhe 2 minuta durim sepse siç ju thashë në fillim të rendit të ditës së sotme, kishim të shtuar dhe një informacion në lidhje me projektin për qeverisjen e mirë, për pjesmarrjen aktive të qytetarëve në projektet me bashkëfinancim. Është diçka që nisi znj.Orgesa që të na e sqaronte qëparë, por duke qënë se ishte tjetër pikë e rendit të ditës, nuk e çoi deri në fund. Do presim vetëm 5 minuta, besoj se keni interes që ajo përmbledhtas ta tregoj se çfarë është kjo nismë dhe të mbyllim këtë mbledhje. Nazmiu- kam dhe unë një problem, është kërkesë nga një familje në fshatin Ngjeqar, rrezikon që ti shkasi shtëpia. Para 3-4 vitesh është bërë një ndërtim, rruga që lidh Kurtaj me Shabanaj dhe aty është bërë një skarpatë për rreth 3 metra dhe nuk është bërë mur mbajtës, dhe aty ka filluar të shkasi toka, gjithashtu ka plasaritje dhe shtëpia. Mundësisht të merret në konsideratë, të paktën të bëhet një mur mbajtës që mos të rrezikohet, bëhet fjalë për në lagjen Zekallarët, nuk ka lidhje me mbiemrin, është një familje të bëhet verifikimi..Maksi- e ke ngritur si kërkesë dhe të kam kthyer përgjigje personale, jo në Këshill..Nazmiu- të bëhet një verifikim..Maksi- për murin mbajtës kemi dërguar ekipin e specializuar atje për emergjencat civile, për murin mbajtës do kalojë me emergjencat civile që do kalojë në fondin e emergjencave civile brenda muajit Mars, e kemi marr në konsideratë..Nazmiu- e keni marr por po bën gati sa të kam thënë..Maksi- tani për shtëpitë thashë edhe njëherë nuk kishte dokumenta që të jemi korrekt me njëri-tjetrin, ajo shtëpi nuk kishte dokument të hipotekuar, ndërsa për murin mbajtës do kalojë tek emergjencat civile të këtij fondi. Leksi- o Kryetar a nuk mundemi dot ne tja zgjidhësh atë përshebull çështjen e dokumentit? Zgjidhe tek hipoteka, tja bëj hipoteka se gjynah..Maksi- po se kemi këtë autoritet..Leksi- po në rregull po meqënëse do ti bëhet, ti bësh atyre..Maksi- ti personalisht ke autoritet si Këshill..Leksi- po çka autoriteti kemi ne, lëre mos më fol me gjuhën e Kryetarit këtu se smë pëllcet fare mua për atë pjesë jo, ta them me sinqeritet, mos fol me ironi domethënë me gjuhën e Kryetarit që kam autoritet, çka leshë autoriteti kam unë? Maksi- njësoj si unë..Leksi- po skam ore fare asnjë lloj autoriteti..Në sallë ka diskutime. Kryetari- të lutem z.Leksi, ju lutem të ruajme etikën dhe 2 minuta. Z.Leksi fjalori juaj është i papranueshëm, z.Maksi a mund të vazhdojmë? Autoriteti i tij është shprehur që në momentin kur ne kemi pranuar që të bëjmë një bashkëpunim me Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive, kemi vënë në dispozicion dhe punonjësit tanë me vendim të këtij Këshilli dhe rezultatet e pritshme nga ne në momentin e votimit

ka qënë zgjidhja e këtyre rasteve. Ky është autoriteti i atij zotrie kur ka ngritur kartonin, tani do ju lutem që të dëgjojmë shkurtimisht në mënyrë të përmbledhur znj.Orgesa. Maksi- po nuk ke kuorumin..Kryetari- ky është informacion, të japim informacionin për ata që duan ta dëgjojnë, ata që sduan ta dëgjojnë..të lutem përmbledhtas. Orgesa- po unë e përmenda pak tek pika e fondeve të trashëguara..Leksi- të përmbledhur bëje..Kryetari- të përmbledhur se nuk kemi votim, vetëm informacion. Orgesa- në kuadër të forcimit të qeverisjes së mirë, Bashkia Roskovec ka marr nismë për hapjen e thirrjes “Qeverisja e mirë përmes pjesmarrjes aktive në bashkëfinancimin e projekteve” si një instrument konkret për rritjen e përfshirjes qytetare dhe bashkëpunimit ndërmjet pushtetit vendor dhe komunitetit. Në përputhje me udhëzimet e thirrjes dhe qëllimet e programit kjo nismë ka si objektiv të përgjithshëm të forcojë qeverisjen e mirë në nivel vendor përmes rritjes së pjesmarrjes aktive të qytetarëve dhe aktorëve lokal në planifikim, bashkëfinancim në zbatimin e projekteve me interes publik, në mënyrë që banorët të mos jenë vetëm përfitues por njëkohësisht dhe bashkëfinancues dhe bashkëzbatues të projekteve. Grupet që ky projekt synon të përfshijë janë organizatat lokale të shoqërisë civile, grupet informale të komunitetit dhe qytetar aktiv dhe përfaqësues të komunitetit. Rezultatet e pritshme, çka presim në fund të këtij projekti është : përmes zbatimit të kësaj nisme rezultohet arritja e rezultateve të mëposhtme: rritja e kapaciteteve të bashkive dhe aktorët lokal për planifikimin dhe menaxhimin e projekteve të bashkëfinancuara, përmirësimi i përfshirjes së qytetarëve dhe organizatat e shoqërisë civile në proceset e vendimmarrjes lokale, zbatimi i projekteve konkrete të bashkëfinancuara që adresojnë një mbrojtje reale të komunitetit dhe kontribuojnë për zhvillimin lokal të qëndrueshëm, rritja e ndërgjegjësimit dhe kujdesit të qytetarëve për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e investimeve publike, si palë të përfshira drejtpërdrejtë në procesin e investimit. Kryetari- mirë faleminderit për informacionin Orgesa, faleminderit për durimin të nderuar këshilltar, këtë mbledhje të Këshillit të Bashkisë e deklarojë të mbyllur.

Sekretar

Arlinda Hajdini



Kryetar

Afrim Plaka

